



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KOMISIONI RREGULLATIV I PROKURIMIT PUBLIK
REGULATIVNA KOMISIJA ZA JAVNE NABAVKE
PUBLIC PROCUREMENT REGULATORY COMMISSION



KOMISIONI RREGULLATIV PËR PROKURIM PUBLIK
PLANI I PËRFORMANCËS PËR VITIN 2024

Nëntor, 2023

Përmbajtja

SHKURTESAT	3
1. Përmbledhje Ekzekutive.....	4
2. Hyrje	5
3. Përmbledhje e Objektivave	9
4. Ndikimi buxhetor	11
4.1 Të Hyrat dhe Shpenzimet	11
B. Pjesa tabelare e Planit të Performancës.....	12

SHKURTESAT

KRPP	Komisioni Rregullativ për Prokurim Publik
MFPT	Ministria e Financave Punës dhe Transfereve
USAID	Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar
EU	Bashkimi Evropian
BB	Banka Botërore
GIZ	Shoqata Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar
OECD	Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik
SIGMA	Mbështetje për Përmirësim në Qeverisje dhe Menaxhim
AKK	Autoriteti Kosovar i Konkurrencës
KKPP	Këshilli Kombëtar për Prokurim Publik
OSHP	Organi Shqyrtues për Prokurim
AMB	Ambasada e Mbretërisë së Bashkuar
DRr	Departamenti i Rregullave
DM	Departamenti i Monitorimit
DTI	Departamenti për Trajnime dhe Integrime
DPSE	Departamenti i Sistemit të Prokurimit Elektronik
DSHP	Divizioni i Shërbimeve të Përbashkëta
ZPMBNJ	Zyrtari Përgjegjës për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore
ZPP	Zyrtari Përgjegjës për Prokurim
ZPF	Zyrtari Përgjegjës për Financa
AP	Aktiviteti i Prokurimit
AK	Autoriteti Kontraktues
OE	Operatori Ekonomik
TEMF	Tenderi Ekonomikisht më i Favorshëm
KMI	Kosovo Municipality Integrity
AKK	Agjencia Kundër Korrupsionit
IKAP	Instituti i Kosovës për Administratë Publike

1. Përmbledhje Ekzekutive

Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik (KRPP) në pajtim me nenin 30, paragrafi 8 të Ligjit Nr.06/l -113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, dhe Rregulloren (qrk) nr. 03/2020 për Performancën e Agjencive, dhe me qëllim të përmbushjes së mandatit të KRPP-së ka përgatitur planin e performancës së KRPP-së për vitin 2024 me përshkrime të objektivave, aktiviteteve dhe treguesve/rezultateve të cilat synohen të arrihen gjatë vitit 2024.

Edhe për vitin 2024 objektivat, aktivitetet dhe rezultatet e përfshira në këtë plan të performancës nuk kanë të bëjnë vetëm me fushën legjislative në sektorin e prokurimit publik në Kosovë si mandat kryesorë që nga themelimi i KRPP-së, por kanë të bëjnë edhe me prokurimin elektronik i cili, KRPP-në përveç mandatit rregullator të prokurimit që ka, e ka shndërruar edhe në ofrues të shërbimeve nëpërmjet sistemit të prokurimit elektronik, duke ditur se që nga viti 2016 KRPP operon dhe administron sistemin e prokurimit elektronik nëpërmjet të cilit zhvillohen të gjitha aktivitetet e prokurimit nga të gjitha autoritetet kontraktuese në Kosovë.

Duhet theksuar që objektivat, aktivitetet dhe rezultatet e përfshira në plan të performancës për vitin 2024 përfshijnë disa nga objektivat e planit të performancës për vitin 2023 për arsye se kanë qenë në varësi të Ligjit të ri të PP, të cilat arsye më gjerësisht tregohen në pjesën e sfidave.

Plani i performancës së KRPP-së për vitin 2024 mbulon objektiva dhe aktivitete të cilat në përgjithësi synojnë:

- Avancimin dhe përditësimin e kuadrit ligjorë të prokurimit publik, me qëllim të harmonizimit me legjislacionin e ri (Ligjin e ri të PP/Direktivat e EU-së) dhe të përdorimit të mjeteve elektronike (Prokurimit Elektronik);
- Rritjen e efikasitetit në sistemin e Prokurimit Publik përmes vendosjes së rregullave dhe monitorimit të zbatimit të tyre si dhe siguroj zbatimin e parimit të transparencës dhe qasjes në informata në të gjitha fazat e aktivitetit të prokurimit gjatë përdorimit të fondeve publike.
- Zhvillimin dhe avancimin e mëtutjeshëm të prokurimit elektronik, me qëllim të operimit të vazhdueshëm të sistemit të prokurimit elektronik;
- Ngritjen e kapaciteteve në prokurim publik, dhe
- Rritjen e nivelit të transparencës në komunikim me publikun nëpërmjet veglave elektronike, programeve të ndërgjegjësimit dhe bashkëpunimit ndërinstitucional, përfshirë shoqërinë civile.

Për zbatimin e planit të performancës për vitin 2024, KRPP ka në dispozicion një buxhet total prej **832,412.00€** (sipas KASH 2024-2026) dhe kryesisht mbështetet në kapacitetet/burimet njerëzore (departamenteve përkatëse) brenda KRPP-së dhe përkrahjen e donatorëve gjithashtu, përkrahje e cila është bërë në vazhdimësi dhe pritet që të vazhdojë edhe gjatë vitit 2024 (ashtu siç është përshkruar më poshtë në këtë plan të performancës).

2. Hyrje

Komisioni Rregullativ për Prokurim Publik (KRPP) është themeluar në vitin 2004, sipas LPP Nr.2003/17. Aktualisht përgjegjësitë e KRPP-së rregullohen me Ligjin Nr. 04/l-042, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092.

Struktura organizative e KRPP-së është përcaktuar nga Bordi i KRPP-së, në bazë të përgjegjësiave dhe detyrave të përcaktuara me Ligjin për Prokurim Publik .

Në përputhje me Ligjin për Prokurim Publik, KRPP udhëhiqet nga Kryetari i Bordit të KRPP-së. Ndërsa Bordi është përgjegjës për miratimin e politikave, aprovon raportin vjetor të prokurimit publik për Kuvendin dhe Qeverinë e Kosovës, nxjerrë dhe aprovon rregullore në kuadër të legjislacionit sekondar për sistemin e prokurimit përkatësisht punës së KRPP-së.

Struktura themelore organizative e KRPP-së përbëhet nga Bordi, katër departamente, nëntë divizione.

- a. Departamenti i Rregullave (DRr)
- b. Departamenti i Monitorimit(DM)
- c. Departamenti për Trajnime dhe Integritet(DTI)
- d. Departamenti i Sistemit të Prokurimit Elektronik(DSPE)
- e. Divizioni i Shërbimeve të Përbashkëta (DSHP)
- f. Zyrtari Përgjegjës për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore(ZPMBNJ)
- g. Zyrtari Përgjegjës për Prokurim (ZPP)
- h. Zyrtari Përgjegjës për Financa (ZPF)

Në pajtim me LPP dhe përgjegjësitë që i jepen nga ky ligj, KRPP ka mandatin e rregullatorit në sektorin e prokurimit publik në Kosovë (përgatitja e kuadrit ligjorë dytësorë, interpretimeve dhe opinioneve në prokurim publik, monitorimi i zbatimit të legjislacionit në prokurim publik, trajnimeve, etj), dhe me aplikimin e prokurimit elektronik i është shtuar edhe mandati ofruesit të shërbimeve gjithashtu.

Prandaj, Plani i përformancës i KRPP-së për vitin 2024, është përgatitur duke pasur parasyshë zhvillimet e viteve të fundit dhe në varësi të nevojave/kërkesës për krijimin e një vizioni më të qartë për trendet e zhvillimit në fushën e prokurimit publik në aspektin legjislativ/rregullator dhe në aspektin e prokurimit elektronik gjithashtu.

Ky plan mbulon periudhën një (1) vjeçare, kryesisht duke renditur objektiva dhe aktivitete që do të zhvillohen, por edhe kërkesa ligjore dhe strategjike në fushën e prokurimit, krahas Strategjisë për Menaxhimin e Financave Publik dhe Planit të Veprimit të Strategjisë, pjese e se cilës është edhe prokurimi publik.

Metodologjia e cila është përdorur në hartimin e planit të përformancës kryesisht është mbështetur në udhëzimet e Rregullores (qrk) nr. 03/2020 për Performancën e Agjencive, më saktësisht në procedurat për hartimin e planit të përformancës së Agjencisë, duke filluar në formimin e grupit punues nga ana e menaxhmentit të KRPP-së, diskutimeve brenda departamenteve përkatëse të KRPP-së, grumbullimit të të dhënave për zhvillimet e viteve të

fundit në sektorin e prokurimit publik, analizimin e raporteve vjetore të kontratave të nënshkruara në prokurim publik, konsultimin me donatorët potencial, etj.

Një pjesë e rëndësishme e të dhënave dhe objektivave për përgatitje të planit të performancës për vitin 2024 ka të bëjë edhe me nivelin e zbatimit apo arritjes së objektivave të planit të performancës se vitit 2023, të cilat sidomos kanë të bëjnë me objektivat e ndërlidhur me miratimin e Ligjit të ri për prokurimin Publik, i cili miratim nuk ka ndodhur gjatë vitit 2023 apo ashtu siç ka qenë planifikuar. Gjithashtu, objektivat e PP për vitin 2024 janë të ndërlidhur edhe me Strategjinë për Menaxhimin e Financave Publike (SMFP) 2022-2026 dhe raportet e institucioneve ndërkombëtare, siç është raporti i EU-së për vitin paraprak.

Sfidat në realizimin e objektivave dhe aktiviteteve të planit të performancës për vitin 2023 janë konsideruar gjithashtu nga KRPP gjatë përgatitjes së planit të performancës për vitin 2024. Mungesa e miratimit të Ligjit të ri për Prokurimin Publik dhe varshmëria nga institucionet e tjera në realizimin e disa nga objektivave, njëjtte si në vitin 2023 edhe këtë vit një nga sfidat kryesore mbetet varësia e realizimit të plotë të objektivave që janë në varësi të Ligjit të ri për prokurimin Publik dhe varshmëria nga veprimet e institucioneve të tjera. Gjithashtu, dihet që Komisioni Rregullativ për Prokurim Publik, që nga themelimi me mandatin e vetëm të rregullatorit në fushën e legjislacionit në prokurim publik është përballur me sfida të ndryshme, e më së shumti në mungesë të kapaciteteve profesionale të brendshme për të përballuar dinamikën e ndryshimeve dhe reformave të kërkuara në fushën e prokurimit publik.

Edhe më tutje aplikimi i prokurimit elektronik dhe mandati i KRPP-së në fushën e prokurimit elektronik, mungesa e kapaciteteve profesionale jo vetëm në fushën e prokurimit publik por edhe në fushën e TI-së, do të jetë sfida më e madhe në realizimin e detyrave, obligimeve dhe përgjegjësisë në raport me objektivat dhe aktivitetet e përfshira në planin e performancës për vitin 2024.

Duhet theksuar që sfida e mungesës së kapaciteteve bëhet edhe më e dukshme duke ditur që viteve të fundit dhe në vazhdimësi KRPP ballafaqohet me ikje të nëpunësve (ekspertëve të prokurimit) me përvojë (duke u angazhuar në projekte/institucione për një pagë më të mirë) dhe ekspertëve të TI-së të cilët gjithashtu pas përvojës së fituar në KRPP janë më atraktiv për sektorin privat ose institucionet ku paguhen më mirë. Për t'a argumentuar këtëdo e theksojmë që vetëm gjatë vitit 2023 KRPP-në e kanë lëshuar tre (3) ekspert të TI-së të cilët kane qenë me një përvojë shumëvjeçare si ekspert të TI-së në KRPP.

Prandaj, duke ditur dinamikën e proceseve dhe zhvillimeve në sektorin e prokurimit publik që pritet të ndodhin gjatë vitit 2024 (sidomos nëse miratohet Ligji i ri i Prokurimit Publik dhe obligimet dhe përgjegjësitë e KRPP-së që burojnë nga ky ligj), mungesa e kapaciteteve/burimeve njerëzore do të jetë sfida kryesore në realizimin e objektivave të planifikuar në planin e performancës edhe për vitin 2024.

Ashtu siç është theksuar edhe në planin e performancës për vitin 2023, sfidë në realizimin e disa nga objektivave të planit të performancës për vitin 2024, përveç mungesës së burimeve njerëzore do të jenë edhe varshmëria nga zhvillimet/proceset të cilat nuk janë në mandatin e KRPP-së, siç janë: miratimi i Ligjit të ri të Prokurimit Publik (që është në mandatin e MFPT/Qeverise dhe Kuvendit dhe nga i cili ligj varen shumica e aktiviteteve në kuadër të objektivit 1 dhe disa aktivitete që kanë të bëjnë me objektivin 3), avancimit të prokurimit elektronik në funksion të ndërvepruesmërisë me sisteme të tjera (që është në varshmëri edhe

te aktiviteteve që duhet implementuar nga institucionet/sistemet e ndërlidhura).

Pra, sfidë kryesore për KRPP-në realizim të objektivave dhe aktiviteteve në këtë plan të performancës do të jenë:

- mungesa e burimeve njerëzore të mjaftueshme dhe me ekspertizë në fushën e prokurimit publik dhe të TI-së në KRPP dhe
- varshmëria e aktiviteteve të parapara në këtë plan të performancës me aprovimin dhe kohën e hyrjes në fuqi të ligjit ri të prokurimit publik.

Gjithashu edhe më tutje si sfidë për KRPP-në mbetet ambienti dhe kushtet e punës për të cilat edhe gjatë vitit 2023 nuk është bërë zgjidhje e përshtatshme.

Nga hapat të cilët KRPP ka planifikuar të ndërmerret për të evituar sfidat e specifikuar më lartë, kryesisht kanë të bëjnë me ri-tentime rreth angazhimit të stafit shtesë nëpërmjet procedurave të rekrutimit, ose angazhimit të ekspertëve për pozita specifike dhe me kohë të caktuar, dhe gjithashtu në një bashkëpunim dhe bashkërendim me projektet e përkrahura nga donatorët potencial, siç janë projektet e USAID, EU, BB, etj.

Përdorimi i termit ri-tentim rreth angazhimit të stafit shtesë nëpërmjet procedurave të rekrutimit, ose angazhimit të ekspertëve për pozita specifike ka të bëjë me tentimet e pasuksesshme gjatë vitit 2023 të KRPP-së që të angazhoj staf shtesë, sidomos në TI si pasojë e pagave të ulëta.

Duhet theksuar që kjo sfidë do të jetë edhe më evidente gjatë vitit 2024, meqenëse për Komisionin Rregullativ të Prokurimit Publik numri i pozitive të kategorizuara dhe kategorizimi i pozitive të TI-së nuk është bërë në pajtueshmëri me shtojcën 14.4 të Ligjit nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik dhe Rregullores (QRK) nr. 11/2023 për ekspertët nga ana e Komisionit për Vlerësimin e Sistemeve Shtetërore të Informacionit dhe Komunikimit me Rëndësi Strategjike.

Bashkëpunimi me donatorë

Bazuar në bashkëpunimin që deri tani KRPP ka pasur me institucionet ndërkombëtare, si: USAID, EU, SIGMA, Ambasada e Mbretërisë së Bashkuar (UK), Qeverinë e Luksemburgut, Banka Botërore dhe diskutimet aktuale me të gjitha këto institucione planifikohet që edhe gjatë vitit 2024 të vazhdohet bashkëpunimi dhe përkrahja konkrete në fushën e prokurimit publik nga komuniteti i donatorëve.

Objektiv kryesorë i mbështetjes dhe përkrahjes kryesisht do të jetë në ofrimin e asistencës dhe shërbimeve të konsulencës për ngritjen e kapaciteteve profesionale të KRPP-së dhe autoriteteve kontraktuese për përmbushjen e detyrave dhe ushtrimin e përgjegjësisë sipas Ligjit, sidomos në përkrahja me ekspert dhe ekspertizë pritet të vazhdojë edhe në vitet në vijim.

Përkrahja nga EU: EU nëpërmjet projektit për ndihmë teknike për mbështetjen e zbatimit të Reformave për Menaxhimin e Financave Publike në Kosovë (të implementuar nga GIZ), bazuar në planin e aktiviteteve të projektit pritet që të vazhdoj ofrimin e përkrahjes së asistencës teknike në fushën e legjislacionit primarë dhe sekondarë, në veçanti fokus do jetë legjislacioni dytësor pas miratimit të Ligjit të Ri për prokurim publik, përkrahje e cila ka qenë planifikuar edhe për vitin 2023 por që nuk është dhënë në tërësi si pasojë e mos aprovimit të

Ligjit të ri për Prokurimin Publik.

Përkrahja nga USAID: Ashtu siç ka ndodhur gjatë vitit 2023, KRPP edhe gjatë vitit 2024 pritet që të ketë përkrahjen e projektit të USAID/KMI (Kosovo Municipality Integrity) të implementuar nga DAI. Edhe gjatë vitit 2024 në kuadër të mbështetjes së këtij projekti fokusi do të jetë në ngritjen e kapaciteteve në fushën e prokurimit në KRPP dhe AK-se, në mënyrë specifike mbështetjen me asistencë teknike dhe financiare në komponenten e prokurimit elektronik dhe monitorimit. Duhet theksuar që aktivitetet e specifikuara në këtë Plan të Performancës për vitin 2024 (në pjesën B, apo tabelare), kanë të specifikuar edhe përkrahjen potenciale nga projekti KMI/USAID.

Përkrahja nga Ambasada e Mbretërisë së Bashkuar: Meqenëse në fund të vitit 2023 do të përfundoj projekti i mbështetur nga Ambasada e Mbretërisë së Bashkuar, i cili ka pasur fokus kryesorë avancimin e sistemit të ankesave në kuadër të sistemit të prokurimit elektronik, atëherë KRPP nuk ka paraparë ndonjë aktivitet në kuadër të këtij plani të performancës që është i ndërlidhur me përkrahje nga Ambasada e Mbretërisë së Bashkuar.

Përkrahja nga donatorë të tjerë potencial: Bazuar në bashkëpunimin dhe diskutimet aktuale me Bankën Botërore, potencialisht gjatë vitit 2024 mund të përfitohet përkrahje nga Banka Botërore në asistencë teknike/profesionale dhe në avancim të sistemit të prokurimit elektronik nëpërmjet projektit të BB i cili ende është në fazën përgatitore Projekti për Përforcimin e Qeverisjes Dixhitale për Ofrimit të Shërbimeve në Kosovë" .

3. Përmbledhje e Objektivave

Në përmbledhjen ekzekutive janë specifikuar objektivat e përcaktuara dhe përfshirë në planin e performancës për vitin 2024 dhe të cilët objektiva KRPP synon t'i realizoj për gjatë vitit 2024. Përshkrim më i detajuar i objektivave, me treguesit e performancës dhe aktivitetet e përfshira për secilin objektiv janë prezantuar në shtojcën tabelare më poshtë. Derisa në këtë pjesë do të ofrohet një përmbledhje për secilin nga objektivat e përfshirë në planin e performancës për vitin 2024.

Objektivi 1: Përditësimi dhe avancimi i kornizës ligjore te prokurimit publik

Aktivitetet:

- Ofrimi i interpretimeve dhe opinioneve sipas kërkesave nga Autoritetet Kontraktuese, Operatorët Ekonomik, OJQ, Mediat, etj.
- Hartimi i legjislacionit dytësor në pajtueshmëri me Ligjin e ri të Prokurimit Publik të miratuar.
- Përgatitja e mjeteve zbatuese të përgjithshme dhe të personalizuara (udhëzues, formular standard)

Objektivi 2: Avancim në monitorim të aktiviteteve të prokurimit dhe administrimit të menaxhimit të kontratave

Aktivitetet:

- Grumbullimi dhe përpunimi i të dhënave nga monitorimi i aktiviteteve të prokurimit me qëllim të përfshirjes së treguesve shtesë të bazuar në faktor të rrezikut
- Monitorimi në kohë reale i aktiviteteve të prokurimit dhe administrimit të menaxhimit të kontratave sipas aplikimit të listave kontrolluese
- Digjitalizimi i listave kontrolluese për monitorim (Lista kontrolluese për: Procedurë të hapur, procedura të kufizuar, procedurë të negociuar, Konkurs i Projektimit, Shërbime të Konsulencës dhe lista kontrolluese për menaxhim të kontratës)

Objektivi 3: Avancimi i sistemit të prokurimit elektronik për të siguruar operim të qëndrueshëm dhe rritje të transparencës në prokurimin publik

Aktivitetet:

- Administrim dhe mirëmbajtje e sistemit të prokurimit elektronik
- Vlerësim në aspektin teknologjik dhe ligjorë për avancim/modifikim të sistemit të prokurimit elektronik, përgatitja e TORs, zhvillimi aplikimi, testimi dhe vënia në përdorim e modifikimeve sipas ToR.
- Zhvillimi, testimi dhe implementimi i ndryshimeve/përditësimeve për ndërlidhje të sistemit të prokurimit elektronik me sistemin e Thesarit
- Zhvillimi, testimi dhe implementimi i aplikacionit për ndërlidhje me sistemin e ARBK

- Realizimi i aktiviteteve te ndërlidhura me adresimin Raportit të Auditimit “Sistemi elektronik i prokurimit publik e-prokurimi“

Objektivi 4: Ngritja e kapaciteteve në prokurim publik

Aktivitetet:

- Vlerësimi i nevojave te AK-se për trajnim dhe certifikim në prokurim publik ne pajtueshmeri sipas kërkesave ligjore neni 25.i LPP-se dhe kerkesave tjera nga AK-te.
- Plotesim i planprogramit të trajnimeve në prokurim publik dhe adaptimi i moduleve konform ketyre plotesimeve.
- Trajnime për zyrtarët e Autoriteteve Kontraktuese në pajtueshmëri me kornizen ligjore te prokurimit publik.
- Trajnime te dedikuara per zyrtarë të Autoriteteve Kontraktuese për aplikimin e kriterit të dhënies TEMF /MEAT.
- Trajnimi i zyrtarëve te AK për menaxhim të kontratave dhe vlerësim të performancës se kontraktoreve permes e-prokurimit duke perfshire aspektet ligjore.
- Trajnimi i zyrtarëve te AK-ve për specifikimin teknik ne prokurim publik
- Përshtatja e sistemit të trajnimit ne përputhje me kornizën e re ligjore.
- Trajnimi i zyrtarëve te AK për ndryshimet ligjore te Ligjit te ri te Prokurimit Publik pas aprovimit

Objektivi 5: Transparencë në komunikim me publikun dhe bashkëpunim ndërinstitucional, komunitetin e donatorëve, bizneset dhe shoqërinë civile.

Aktivitetet:

- Organizimi dhe mbajtja e takimeve te rregullta të institucioneve kyçe ne prokurim publik te koordinuara nga KRPP (shkëmbimi i informatave, adresimi i çështjeve të identifikuara, identifikimi i aktiviteteve të përbashkëta pasuese, identifikimi i nevojave për trajnim, etj.).
- Organizimi dhe mbajtja e takimeve te rregullta me donatore, biznese dhe shoqerine civile
- Funkcionalizim i plotë i web faqes institucionale dhe promovimi në rrjete sociale
- Analizimi dhe përpunimi i te dhënave ne prokurim publik sipas prioriteteve te përcaktuara

4. Ndikimi buxhetor

Në përputhje me legjislacionin në fuqi, KRPP-ja është një agjenci jofitimprurëse dhe duke pasur parasysh këtë status, të ardhurat dhe shpenzimet e paraqitura në këtë Plan kanë për qëllim zgjerimin e të dhënave financiare për të ardhurat dhe shpenzimet e KRPP-së, por jo për rezultatet financiare, sepse është e qartë se KRPP-ja nuk është një organizatë fitimprurëse.

<i>Planifikimi i të hyrave për vitin 2024</i>	<i>Planifikimi i të hyrave për vitin 2025</i>	<i>Planifikimi i të hyrave për vitin 2026</i>
NA	NA	NA

4.1 Të Hyrat dhe Shpenzimet

Buxheti i planifikuar i KRPP-së, sipas Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve, është si me poshtë.

	<i>Viti 2024</i>	<i>Viti 2025</i>	<i>Viti 2026</i>
Totali	832,412.00 €	722,835.00 €	733,582.00 €
Nr. i punëtorëve	42	42	42
Pagat dhe Mëditjet	318,582.00 €	318,582.00 €	318,582.00€
Mallrat dhe Shërbimet	248,830.00 €	299,253.00€	310,000.00 €
Shpenzimet Komunale	5,000.00 €	5,000.00 €	5,000.00 €
Subvencionet dhe Transferet	0.00	0.00	0.00
Shpenzimet Kapitale	260,000.00 €	100,000.00 €	100,000.00 €
Burimet e Financimit	Buxheti i Kosovës	Buxheti i Kosovës	Buxheti i Kosovës
Grantet qeveritare	0.00	0.00	0.00
Të hyrat vetanake	0.00	0.00	0.00
Financimet nga huamarrjet	0.00	0.00	0.00
Grantet nga donatorët	0.00	0.00	0.00

Duhet theksuar që në burimet e financimit nuk janë përfshirë burimet që do përfitohen nga përkrahja e donatorëve potencial, meqenëse në kohën e përgatitjes së planit të performancës nuk dihet ende për përkrahjet specifike që do të ofrohen. Nga diskutimet dhe konsultimet e deritanishme shumica e donatorëve edhe me tutje presin aprovimin e Ligjit të ri të Prokurimit Publik në mënyrë që të dihet saktë rreth aktiviteteve në të cilat do të ofrojnë përkrahje, përfshirë nivelin e angazhimit dhe koston buxhetore gjithashtu për secilin angazhim.

B. Pjesa tabelare e Planit të Performancës

Nr.	Objektivat strategjike, treguesit dhe aktivitetet	Vlera bazë			Caku	
I.	Objektivi 1: Përditësimi dhe avancimi i kornizës ligjore të prokurimit publik					
1	Treguesi i performances: Përditësimi i interpretimeve dhe opinioneve nga KRPP sipas kërkesave për të gjitha palët e interesuara	50 [2023]			+10%	
2	Treguesi i performances: Akte dytësore të plotësuara /ndryshuara sipas kornizës ligjore për prokurim publik	85 [2023]			Se paku 10%	
Nr.	Aktiviteti	Drejtoria përgjegjëse	Afati i zbatimit	Buxheti	Burimi i financimit	Produkti
1.1	Ofrimi i interpretimeve dhe opinioneve sipas kërkesave nga Autoritetet Kontraktuese, Operatorët Ekonomik, OJQ, Mediat, etj.	KRPP/Dep. i Rregullave	K1-K4	S'ka implikim buxhetorë	KRPP	Interpretime dhe opinione për zbatueshmëri të drejte të ligjit të prokurimit.
1.2	Hartimi i legjislacionit dytësor në pajtueshmëri me Ligjin e ri të Prokurimit Publik të miratuar.	KRPP/Dep. i Rregullave (DRr), dhe potencialisht donatorët(BE)	K1-K4	35,000 €	KRPP dhe potencialisht projekti i EU	Legjislacioni dytësor i domosdoshëm për fillim të zbatimit të ligjit ri të PP.

PLANI I PËRFORMANCËS PËR VITIN 2024

1.3	Përgatitja e mjeteve zbatuese të përgjithshme dhe të personalizuara (udhëzues , formular standard)	KRPP/Dep. i Rregullave (DRr) dhe departamentet e tjera të KRPP	K1-K4	10.000 €	KRPP	Se paku dy udhëzues te përgatitur dhe tre formular te përditësuar
Buxheti i përgjithshëm për Objektivin 1:				45,000€		
Nr.	Objektivat strategjike, treguesit dhe aktivitetet				Vlera bazë	Caku
II.	Objekivi 2: Avancim në monitorim të aktiviteteve të prokurimit dhe administrimit të menaxhimit të kontratave					
1	Treguesi i performancës: Rritje e numrit të indikatorëve të rrezikut për të monitoruar aktivitetet e prokurimit				5 (2023)	+1 indikatorë
2	Treguesi i performancës: Aplikimi i metodologjise per monitorim				0 (2023)	1 (2024)
3	Treguesi i performancës: Ulje e vlerës se kontratave nëpërmjet procedurave të negociuara				14%(2023)	Ulje për 10% (2024)
4	Treguesi i performancës: Metodologji e digjitalizuar per monitorim				0(2023)	1(2024)
Nr.	Aktiviteti	Drejtoria përgjegjëse	Afati i zbatimit	Buxheti	Burimi i financimit	Produkti
2.1	Grumbullimi dhe përpunimi i të dhënave nga monitorimi i aktiviteteve të prokurimit me qëllim të përfshirjes së treguesve shtesë të bazuar në faktor të rrezikut	KRPP/Dep. i Monitorimit	K1-K4	S'ka implikime buxhetore	KRPP	Listë e indikatorëve shtesë të identifikuar sipas faktorëve të rrezikut dhe për aplikim në proceset e monitorimit.

PLANI I PËRFORMANCËS PËR VITIN 2024

2.2	Monitorimi i aktiviteteve të prokurimit dhe administrimit të menaxhimit të kontratave ne kohe reale sipas aplikimit te listave kontrolluese	KRPP/Dep. Monitorimit	K1-K4	S'ka implikime buxhetore	KRPP/Dep monitorimit	<p>Intervenim dhe adresimi për përmirësim dhe ngritje te cilësi ne përgatitjen e DT. Llogaridhënie e shtuar në prokurim publik nga ana e AK-së;</p> <p>Krijimi i regjistrit të AK lidhur me intervenimet dhe adresimin e gjetjeve gjate monitorimit;</p> <p>Ulje në minimum i kontratave të nënshkruara të cilat implementohen pa plan për menaxhim të Kontratës dhe pa të dhëna rreth progresit të implementimit të kontratës;</p> <p>Rritja e numrit të kontratave të vlerësuara në performancë të implementimit dhe rritja e numrit të kontraktuesve me histori të performancës në kontratat e implementuara.</p>
2.3	Digjitalizimi i listave kontrolluese per monitorim (Lista kontrolluese për Procedurë të Hapur, Lista kontrolluese për Procedura të Kufizuar) Lista për procedurë të negociuar, Konkurs i Projektimit, Shërbime të Konsulencës dhe lista kontrolluese per menaxhim te kontrates.	KRPP/DSPE/Departamenti i monitorimit	K1-K3	S'ka implikim buxhetorë	KRPP/DSPE/Departamenti i monitorimit	<p>- Rritje e efikasitetit ne monitorim te aktiviteteve te prokurimit publik</p>

	<i>Buxheti i përgjithshëm për Objektivin 2:</i>			0		
Nr.	Objektivat strategjike, treguesit dhe aktivitetet				Vlera bazë	Caku
III.	Objektivi 3: Avancimi i sistemit te prokurimit elektronik për të siguruar operim të qëndrueshëm dhe rritje të transparencës në prokurimin publik					
1	Treguesi i performances: Operim i qëndrueshëm i sistemit të prokurimit elektronik				100% [2023]	100%
2	Treguesi i performances: Sistemi i prokurimit elektronik ne pajtueshmëri me Ligjin e ri të PP				50% [2023]	Përkrahje e së paku 80% të ndryshimeve ligjore
3	Treguesi i performances: Sistemi i prokurimit elektronik i ndërveprueshëm me sisteme të tjera qeveritare				1 [2023]	+2
Nr.	Aktiviteti	Drejtoria përgjegjëse	Afati i zbatimit	Buxheti	Burimi i financimit	Produkti
3.1	Administrim dhe mirëmbajtje e sistemit të prokurimit elektronik	KRPP/DSPE /Kontraktuesi	K1-K4	170,000€	KRPP	Realizim i aktiviteteve te prokurimit nga ana e AK-se pa probleme dhe në kohë. Pjesëmarrje e sigurt dhe e lehtësuar e OE në aktivitete të prokurimit, pa diskriminim dhe plotësisht transparent; dhe disponueshmeri në kohë reale e të dhënave të prokurimit për të gjitha palët e interesuara

PLANI I PËRFORMANCËS PËR VITIN 2024

3.2	Vlerësim në aspektin teknologjik dhe ligjorë për avancim/modifikim të sistemit të prokurimit elektronik, përgatitja e TORs, zhvillimi aplikimi, testimi dhe vënia në përdorim e modifikimeve sipas TOR.	KRPP/ DSPE /Kontraktuesi	K1-K4	120,000 € , me përfshirje të donatoreve	KRPP dhe potencialisht donatorët.	Sistem i prokurimit elektronik që përkrahë zhvillimin e procedurave të prokurimit sipas ndryshimeve ligjore, sidomos në aplikimin e vetë deklaratimit, pragjeve të reja të prokurimit, aplikimin e kriterit “ Çmimi ekonomikisht më i favorshëm” si kriter i dhënies, ndarjen e OB në Autoritete kontraktuese dhe Entitete Kontraktuese, etj
3.3	Zhvillimi, testimi dhe implementimi i ndryshimeve/përditësimeve për ndërlidhje të sistemit të prokurimit elektronik me sistemin e Thesarit	KRPP, MFPT	K1-K4	75,000€	KRPP	Kontroll i automatizuar i disponueshmërisë së mjeteve dhe nevojave gjatë inicimit të aktiviteteve të prokurimit nga ana e AK-se. Te dhëna të detajuara dhe në kohë reale për statusin e aktiviteteve të prokurimit për të cilat janë zotuar mjete financiare. Te dhëna të detajuara dhe transparente për statusin e kontratave në implementim dhe gjendjen e pagesave për kontratat të cilat paguhën nga buxheti i Kosovës . Përmirësim në të dhënat e kontratave shumëvjeçare në implementim – të dhëna të

PLANI I PËRFORMANCËS PËR VITIN 2024

						cilat shfrytëzohen për përgatitje dhe ekzekutim të buxhetit të Kosovës nga ana e MFPT.
3.3	Zhvillimi, testimi dhe implementimi i aplikacionit për ndërlidhje me sistemin e ARBK	KRPP/DSPE	K1-K3	10,000€	KRPP dhe potencialisht donatorët	Te dhena shtese dhe te sakta mbi OE pjesemarrës në prokurimin publik dhe sidomos në OE kontraktues.
3.4	Realizimi i aktiviteteve të ndërlidhura me adresimin Raportit të Auditimit “Sistemi elektronik i prokurimit publik e-prokurimi“	KRPP/DSPE	K1-K3	10,000€	KRPP dhe potencialisht donatorët (projekti KIM/USAID)	Procedura standarde të përditësuara për siguri të informacionit Rritja e nivelit të sigurisë së informacionit në përdorim të sistemit të prokurimit elektronik Rritja e nivelit të besueshmërisë së përdoruesve në përdorim të sistemit të prokurimit elektronik
	<i>Buxheti i përgjithshëm për Objektivin 3:</i>			385,000€		

Nr.	Objektivat strategjike, treguesit dhe aktivitetet	Vlera bazë	Caku
IV.	Objektivi 4: Ngritja e kapaciteteve në prokurim publik		
1	Treguesi i përformances: Rritja e numrit të zyrtarëve të certifikuar në prokurim publik	592 (2023)	Deri ne 81 zyrtare ne nivelin e avancuar dhe deri në 140 zyrtare te trajnuar dhe certifikuar ne nivelin themelor profesional ne prokurim publik.
2	Treguesi i përformances: Trajnim për auditorët e ZKA-së për prokurim publik sipas Marrëveshjes së Bashkëpunimit	114 (2023)	Deri në 110 auditorë të trajnuar
3	Treguesi i përformances: Rritja e numrit të zyrtarëve të AK-se të trajnuar në përdorim kriterit të dhënies TEMF /MEAT	197 (2023)	Deri ne 50 zyrtare te trajnuar
4	Treguesi i përformances: Rritja e numrit të zyrtarëve të AK-se të trajnuar për menaxhim të kontratave dhe vlerësim të performancës së kontraktoreve përmes e-prokurimit duke përfshirë aspektet ligjore	590 (2023)	Min. 150 zyrtarë të trajnuar
5	Treguesi i përformances: Rritja e numrit të zyrtarëve të trajnuar të AK-ve për specifikimin teknik	0 (2023)	Min. 100 zyrtarë të trajnuar

PLANI I PËRFORMANCËS PËR VITIN 2024

Nr.	Aktiviteti	Drejtoria përgjegjëse	Afati i zbatimit	Buxheti	Burimi i financimit	Produkti
4.1	Vlerësimi i nevojave të AK-se për trajnim dhe certifikim në prokurim publik në pajtueshmeri sipas kërkesave ligjore nën 25 të LPP-se dhe kërkesave tjera nga AK-te. <i>(Raportet e ndërkombëtare, të dhënat e KRPP-se, kërkesat e AK-ve, anketat e realizuar)</i>	KRPP/Departamenti i Trajnimeve / IKAP	K1-K4	S'ka implikim buxhetorë	KRPP dhe potencialisht donatorët	Plotësimi i nevojave të AK për zyrtarë të certifikuar në prokurim publik. Certifikimi i zyrtarëve sipas nenit 25 të LPP.
4.2	Plotësim i planprogramit të trajnimeve në prokurim publik dhe adaptimi i moduleve konform ketyre plotësimeve <i>(Në bazë të anketës me AK-se dhe analizës, për sistemin e trajnimeve në fushën e prokurimit publik të realizuar gjatë vitit 2023)</i>	KRPP/Departamenti i Trajnimeve / IKAP	K1-K4	S'ka implikim buxhetorë	KRPP/ IKAP/ Trajnerët	Ngritje e cilësisë së trajnimeve në prokurim publik

PLANI I PËRFORMANCËS PËR VITIN 2024

4.3	Trajnime për zyrtarët e Autoriteteve Kontraktuese në pajtueshmëri me kornizen ligjore të prokurimit publik.	KRPP/ Departamenti i Trajnimeve/IKAP	K1-K4	S'ka implikim buxhetorë	KRPP/IKAP	Kapacitete të mjaftueshme në AK për të zhvilluar aktivitete të prokurimit në pajtueshmëri me Ligjin e PP.
4.4	Trajnime të dedikuara për zyrtarë të Autoriteteve Kontraktuese për aplikimin e kriterit të dhënies TEMF /MEAT.	KRPP/ Departamenti i Trajnimeve	K1-K4	S'ka implikim buxhetorë	KRPP dhe potencialisht nga donatorët	Forcimi i kapaciteteve profesionale për aplikimin të TEMF në fushën e prokurimit publik.
4.5	Trajnimi i zyrtarëve të AK për menaxhim të kontratave dhe vlerësim të performancës së kontraktoreve përmes e-prokurimit duke përfshirë aspektet ligjore.	KRPP/ Departamenti i Trajnimeve	K1-K4	S'ka implikim buxhetorë	KRPP dhe potencialisht nga donatorët	Forcimi i kapaciteteve profesionale për përdorim të moduleve të menaxhimit të kontratës dhe vlerësim të performancës duke përfshirë aspekte ligjore.
4.6	Trajnimi i zyrtarëve të AK-ve për specifikimin teknik në prokurim publik	KRPP/ Departamenti i Trajnimeve/AK	K1-K4	S'ka implikim buxhetorë	KRPP dhe potencialisht nga donatorët	Forcimi i kapaciteteve profesionale për specifikimin teknik në prokurim publik

PLANI I PËRFORMANCËS PËR VITIN 2024

4.7	Përshatja e sistemit të trajnimit ne përputhje me kornizën e re ligjore.	KRPP/ Departamenti i Trajnimeve/AK	K1-K4	S'ka implikim buxhetorë	KRPP dhe potencialisht nga donatorët	Përgatitja e skemës, planit dhe metodologjisë së sistemit të trajnimit në përputhje me LPP-në e re
4.8	Trajnimi i zyrtarëve te AK për ndryshimet ligjore te Ligjit te ri te Prokurimit Publik pas aprovimit	KRPP/ Departamenti i Trajnimeve	K1-K4	S'ka implikim buxhetorë	KRPP dhe potencialisht nga donatorët	Kapacitete te mjaftueshme ne AK për te zhvilluar aktivitete te prokurimit ne pajtueshmëri me Ligjin e PP.
Nr.	Objektivat strategjike, treguesit dhe aktivitetet				Vlera bazë	Caku
V.	Objektivi 5: Transparencë në komunikim me publikun dhe bashkëpunim ndërinstitucional, komunitetin e donatorëve, bizneset dhe shoqërinë civile.					
1	Treguesi i përformances: Takime periodike të përbashkëta ndërinstitucionale				3 (2023)	3 takime
2	Treguesi i përformances: Takime periodike me komunitetin e donatoreve, bizneseve dhe shoqërinë civile				3 (2023)	5 takime
3	Treguesi i performancës: Publikim i raporteve statistikore dhe te analizes mbi aktivitetet e prokurimit				1 (2023)	Se paku dy raporte

PLANI I PËRFORMANCËS PËR VITIN 2024

Nr.	Aktiviteti	Drejtoria përgjegjëse	Afati i zbatimit	Buxheti	Burimi i financimit	Produkti
1	Organizimi dhe mbajtja e takimeve të rregullta të institucioneve kyçe në prokurim publik të koordinuara nga KRPP (shkëmbimi i informatave, adresimi i çështjeve të identifikuara, identifikimi i aktiviteteve të përbashkëta pasuese, identifikimi i nevojave për trajnim, etj).	KRPP	K1-K4	S'ka implikim buxhetorë	KRPP	Ngritja e bashkëpunimit dhe koordinimit ndërmjet institucioneve kyçe relevante në prokurimin publik, për një zbatim në mënyre të duhur të Kornizës rregullative në prokurim publik.
2	Organizimi dhe mbajtja e takimeve të rregullta me donatore, biznese dhe shoqëri civile	KRPP	K1-K4	S'ka implikim buxhetorë	KRPP dhe potencialisht nga donatorët	Rritje e bashkëpunimit në zhvillimet e sektorit të prokurimit publik Koordinimi i aktiviteteve të mbështetura nga donatorët (USAID, EU, etj)
3	Funksionalizim i plotë i web faqes institucionale dhe promovimi në rrjete sociale	KRPP	K1-K2	Ska implikim buxhetorë	KRPP	Te dhena dhe informacione në kohë reale mbi zhvillimet në sektorin publik.
4	Analizimi dhe përpunimi i të dhënave në prokurim publik sipas prioriteteve të përcaktuara	KRPP	K1-K4	S'ka implikim buxhetorë	KRPP	Krijimi dhe publikimi i raporteve periodike